

Specialist (Profili teknik) në Sektorin e Analizës së Përputhshmërisë dhe Kontrollit, Drejtoria e Analizës së Përputhshmërisë, Riskut dhe Kontrollit të Masave të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 25/24 “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 783 datë 18.12.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 24.07.2024 “Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, urdhrin të Kryeministrit nr. 239, datë 16.12.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist (Profili teknik) në Sektorin e Analizës së Përputhshmërisë dhe Kontrollit, Drejtoria e Analizës së Përputhshmërisë, Riskut dhe Kontrollit të Masave të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Kontrollon dokumentimin dhe implementimin e masave minimale të sigurisë, teknike dhe organizative, nga operatorët e Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet ndërkombëtare;
- Kontribuon në përgatitjen dhe hartimin e rekomandimeve për mirëqeverisjen e sigurisë kibernetike në Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit;
- Përgatit kalendarin e Kontrollit, duke koordinuar punën me përgjegjës të sektorit për kontrollin periodik të OIKI dhe OIRI;
- Kontribuon në hartimin e Raporteve të Kontrollit të Operatorëve të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit dhe kontrollon zbatimin e masave dhe rekomandimeve, sipas Raportit të Kontrollit;
- Kontribuon në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planit të Veprimt;
- Kontribuon në Hartimin e Raportit Vjetor të Qeverisjes së Sigurisë Kibernetike në Republikën e Shqipërisë;
- Kontribuon në hartimin e planit të trajnimeve për Infrastrukturat Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit, si dhe institucionet përgjegjëse për sigurinë kibernetike;
- Siguron ndihmë metodike, kur i kërkohet, strukturave të tjera të Autoritetit.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Të zotërojë diplomë të nivelit minimal “Master Profesional”, në Shkenca Inxhinierike, Informatike, Kompjuterike, Elektrike.

Përvoja: Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion, nga të cilat jo më pak se 1 vit në fushën e sigurisë kibernetike.

FUSHA E NJOHURIVE:

- Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:
- Legjislacionin e Sigurisë Kibernetike;
- Standarde ndërkombëtare ISO 27001/NIST/SIM3 Maturity Mode/ENISA.

Aftësi për të:

- Integruar informacionin me politikat institucionale;
- Identifikuar dhe qartësuar çështje e dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale;
- Analizuar, komunikuar, prezantuar, si dhe për të pranuar metoda dhe procedura të reja;
- Përparësi certifikime profesionale të fushës si: ISO 27001:2013 ‘Lead Auditor’; CISA, CISSP; ‘Cyber Intelligence’, ‘Information System Auditing’; ‘Conformity Assessment Body–eIDAS Regulation (EU) 910/2014’; ‘International Law of Cyber Operation’; CompTIA Security+;
- Të njohë mirë gjuhën angleze.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (IV-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 26.06.2026, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@aksk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.